

DuaReise Bulevardi Bill Clinton Prishtine - Autoritet ligjore: Prishtina/Kosova

DuaReisen është një organizator fluturimesh. Për të gjitha fluturimet e rregullta dhe fluturimet charter që ndërmjetësohen nga DuaReisen, vlejné kushtet dhe termat e përgjithshme për transport (ABB) të aviokompanive që i realizojné fluturimet. Të gjitha referencat shërbejnë vetëm si informacion.

### 1. Para fluturimit

1.1 Në Check-in, duhet t'i keni të gatshme me vete dokumentet e udhëtimit dhe kodin e rezervimit.

1.2 Pasagjerët duhet të jenë të pranishëm në Check-in të aeroportit së paku

2 orë para fluturimit.

### 2. Bagazhi

Rregullorja për bagazh ndryshon varësisht nga aviokompania. Vlen dhe duhet të respektohet rregullorja e aviokompanisë që e realizon fluturimin. Parimisht vlejné rregullat në vijim: Bagazhi i dorëzuar për të rritur (ADL): Peshë maksimale: 20kg. Bagazhi i dorëzuar për fëmijë të vegjël (INF): Peshë maksimale: 10kg. Valixhja e dorës: Peshë maksimale: 5kg. Duhet përmbajtur rregullave për valixhe të dorës dhe rregulloreve aktuale të sigurisë.

### 3. Kushtet e rezervimit

3.1 Biletat e DuaReisen mund t'i rezervoni online (në ueb-faqen [www.DuaReisen.eu](http://www.DuaReisen.eu)), në zyrat partnere ose në Call Center të saj. Varësisht nga mënyra e rezervimit, pasagjerit i dërgohet kodi i rezervimit nëpërmjet të e-mailit, SMS-it, ose telefonit në qoftë se ka rezervuar në Call Center të DuaReisen.

3.2 Rezervimi vlen si i kryer, atëherë kur udhëtari pranon vërtetim rezervimi nga DuaReisen nëpërmjet të e-postës ose SMS-it. Nëse rezervimi bëhet në Call Center me anë të telefonit, atëherë si vërtetim vlen një deklaratë joformale ose një veprim kyç (siç është dhënia e kodit të rezervimit nëpërmjet të telefonit etj.).

3.3 Pasagjeri obligohet që të kontrollojë menjëherë saktësinë e të dhënave të rezervimit që i ka pranuar nëpërmjet të postës elektronike, SMS-it ose telefonit dhe në rast se vëren pasaktësi, gabime, ose në qoftë se nuk i ka pranuar fare, duhet të informojë DuaReisen. Pasaktësitë ose gabimet e lajmëruara me vonesë nuk ju japin të drejtë të tërhiqeni nga kontrata.

3.4 Vlejné shërbimet dhe çmimet e biletave që vërtetohen në kohën e rezervimit. Çmimet e biletave në ueb-faqen tonë aktualizohen rregullisht. Ato mund të shtrënjtohen ose lirohen. Ofertat speciale dhe zbritjet janë subjekt ndryshimi.

3.5 Transporti i pasagjerit mund të realizohet vetëm nëse posedon dokumentet e nevojshme dhe valide për udhëtim (pasaportë, ID- letërnjoftim, kod rezervimi, vizë etj.). Secili udhëtar përgjigjet vetë për respektimin e dispozitave lidhur me udhëtimin. Pasagjeri i cili nuk do të transportohet për shkak se nuk u është përmbajtur dispozitave të udhëtimit për hyrje dhe dalje nga shteti, nuk ka të drejtë të kërkojë rikthimin (kompensimin) e çmimit të biletës.

3.6 Nëse pasagjerit i mohohet hyrja në një shtet, ai obligohet t'i marrë përsipër të gjitha shpenzimet që do të krijohen për t'u kthyer nga ai vend. Çmimi i biletës, me të cilin ka udhëtuar deri në shtetin ku i është mohuar hyrja, nuk do t'i kompensohet pasagjerit.

3.7 Rezervimi duhet të jetë në emër të personit i cili do të udhëtojë. Në të kundërtën, këtij personi nuk do t'i lejohet udhëtimi. Në këso rastesh përjashtohet kthimi i mjeteve të biletës.

3.8 Fëmijët nën moshën 5 vjeçare, në parim mund të udhëtojnë vetëm në shoqërim të një personit të rritur mbikëqyrës. Fëmijët pa shoqëruar (5 - 12 vjet) duhet të lajmërohen/regjistrohen së paku 48 orë para fluturimit tek DuaReisen, përndryshe nuk mund të garantohet transporti i tyre.

3.9 Arritja e ndonjë fluturimi lidhës nuk garantohet.

### 4. Pagesat

4.1 Biletat të cilat rezervohen në DuaReisen mund të paguhen me kredi-kartela që pranohen nga DuaReisen ose me transaksion bankar. Biletat, gjithashtu, mund të paguhen në zyrat e DuaReisen si dhe në kesh në sportelet e DuaReisen në aeroport.

4.2 Obligim i pasagjerit është që t'i japë të dhënat e sakta e një kredi-kartele valide, dhe jo të falsifikuar ose të manipuluar. Në të kundërtën, DuaReisen nuk mund të garantojë për çmimin apo rezervimin e dhënë si në fillim.

4.3 Në rast se pagesa nuk kryhet fare ose nuk bëhet në kohën e duhur, DuaReisen ka të drejtë të refuzojë realizimin e shërbimeve, posaçërisht transportin e pasagjerit. Përveç kësaj, DuaReisen ka të drejtë të angazhohet një ndërmarrje inkasojë për të arkëtuar borxhin. Në rast të paafetësisë ose mosgatishmërisë për pagesë, vonesa (borxhi) do të denoncohet në organet ose shoqëritë kompetente (SCHUFA, Zyra për arkëtimin e borxheve etj.).

### 5. Ndryshimet e fluturimit, e emrit dhe anulimit

5.1 Ndryshimet e fluturimit -nëse ka vende të lira për fluturimin e ri të dëshiruar -mund të bëhen deri në 200 orë para fluturimit më një ngarkesë prej 150 €, për çdo pasagjer. Përveç kësaj, mund të dalin edhe 1shpenzime të tjera shtesë si pasojë e ndryshimit të tarifës. Nëse gjatë ndryshimit zgjidhni fluturim më të lirë, vlen çmimi i rezervimit të parë. Ndryshimet në emër mund të bëhen me një ngarkesë prej 350 €, për çdo pasagjer. Rezervimet (fluturimet dhe/apo emrat) mund të ndryshohen nëpërmjet të telefonit në Call Center të DuaReisen ose në zyrat e DuaReisen.

5.2 Pasagjeri është i obliguar të shfrytëzojë edhe vajtjen edhe ardhjen.

Nëse nuk shfrytëzohet vajtja, ardhja (kthimi) automatikisht do të anulohet. Kthimi i çmimit të biletës përjashtohet. E njëjta vlen edhe për mos-shfrytëzimin e ardhjes (kthimit).

5.3 Pasagjeri ka të drejtë të tërhiqet nga shfrytëzimi i fluturimit(brenda 30 minutav nga rezervimi i biletës. Vendimtare është koha e pranimit të anulimit të rezervimit nga DuaReisen. Sugjerohet të jepet sqarim me shkrim. Anulimi pas nisjes së fluturimit nuk është më i mundur. Në rast të anulimit të fluturimit të rezervuar, janë caktuar për t'u paguar këto kompensime për anulim:

nga 21 deri në 14 ditë para fluturimit -50% e çmimit të biletës,

nga 14 deri në 10 ditë -75% e çmimit të biletës,

nga 10 deri në 0 ditë para fluturimit -100% e biletës.

Rekomandohet të lidhet marrëveshje për sigurim. Kthimi i pjesshëm ose i tërësishtëm i mjeteve të biletës mund të bëhet vetëm në formë të një kredie Kupon.Kuponi është valide 6 muaj nga data e lëshimit. Nëse ajo nuk shfrytëzohet brenda afatit të caktuar, nuk vlen më.

5.4 Ofertat speciale në kontingjent, bileta e të cilave kushton më pak se 60 Eur,- (fluturime njëdrejtëshe me gjithë tatime dhe taksa) nuk mund as të ndryshohen e as të kompensohen.

5.5 Taksat e DuaReisen mund të ndryshojné në çdo kohë. Këtu bëhet fjalë për taksat për rezervim nëpërmjet të telefonit, pagesat me kredi-kartelë, anulimet, ndryshimet e rezervimit ose të tjera. Këto taksa, në çdo kohë mund të reduktohen, të rriten, madje edhe të mënjanohen krejtësisht.

### 6. Dëmtimi i bagazhit dhe humbja e bagazhit

Për dëmtim të pasagjerit, bagazhit dhe mallrave vlejné konventa të caktuara ndërkombëtare të cilat i rregullojnë detyrimet në raste të tilla. Çdo reklamacion duhet të bëhet në formë të shkruar tek aviokompania e cila e realizon fluturimin.

### 7. Fluturimet

Pasagjerët do të udhëtojnë me aeroplanet e linjeve të rregullta dhe charter të aviokompanive zvicerane ose të huaja. Oraret e publikuara të fluturimeve, aviokompanitë dhe llojet e fluturimeve mund të pësojnë ndryshime afatshkurtëra. Keto Ndryshime nuk e bëjnë Përgjegjse DuaReisen

### 8. Reklamacionet (ankesat)

Ankesat duhet të bëhen pa u vonuar deri të Shërbimi i konsumatorëve të DuaReisen [info@DuaReisen.eu](mailto:info@DuaReisen.eu)

### 9. Përdorimi i Ueb-faqes

Informatat, produktet dhe shërbimet të cilave mund t'u qaseni përmes kësaj ueb-faqeje, nuk lejohet të ndryshohen apo të përdoren për qëllime tjera.

### 10. Pranimi i këtyre kushteve dhe termave (AGB)

Përdorimi i ueb-faqes [www.airprishtina.com](http://www.airprishtina.com) dhe shërbimet e prezantuara aty nga DuaReisen, janë subjekt i termave dhe kushteve të përgjithshme (AGB). Duke përdorur këtë ueb-faqe, ju i pranoni kushtet dhe termat si të tëra, përndryshe nuk ju lejohet përdorimi i webfaqes dhe shërbimet e ofruara aty nga DuaReisen.

### 11. Marrëveshjet shtesë

Marrëveshjet shtesë, amendamentet, ndryshimet ose sigurimet tjera janë të efektshme vetëm atëherë kur të konfirmohen me shkrim.

### 12. Ligji në fuqi

Kontrata është subjekt i ligjit Kosovar. Juridiksioni i Prishtinës, Kosove. Versioni gjerman i këtyre termave dhe kushteve ka përparësi nga versioni i përkthyer. 13. Klausola Salvatore (e veçimit) Nëse një ose më shumë dispozita të kësaj kontrate janë ose bëhen të pavlefshme, nuk prekt vlefshmëria e dispozitave të tjera.

14. Gjendja Këto dispozita vlejné nga 23.04.2024. Në rast se keni vështrësi për t'i kuptuar këto informata, thirrni për ndihmë në Call Center DuaReisen +491759999470